**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës Jugore**
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**Kryetari i Komunës**
**Nr.** 01-020/04-0045388-2/24 dt. 11.07.2024
**Mitrovicë**

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kontratën e Prokurimit Nr. 01-370/01-0041283/24, dt.19.06.2024, Nr. të prokurimit 642-24-5130-2-2-1 dhe Numër të Brendshëm të Prokurimit: 642/24/004-2-2-1, me titull "Mirëmbajtje dhe Servisim të Veturave Zyrtare në KK. Mitrovicë " si dhe Propozim – Vendimin e Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme Nr. 01-020/04-0045388/24, 08.07.2024, Kryetari i Komunës sjell këtë:

# V E N D I M

**(Për formimin e Komisionit për Pranimin Teknik të Punimeve të Kryera në Mirëmbajtje dhe Servisim të Automjeteve sipas Kontratës "Mirëmbajtje dhe Servisim të Veturave Zyrtare në KK. Mitrovicë")**

1. Formohet Komisioni për Pranimin Teknik të Punimeve të Kryera në Mirëmbajtje dhe Servisim të Veturave Zyrtare në KK. Mitrovicë" , në këtë përbërje:

    1.1. Haxhi Ahmeti – kryetar;
    1.2. Brahim Haziri – anëtar;
    1.3. Driton Zeneli – anëtar.

2. Komisioni është përgjegjës që të bëj Pranimin teknik të punëve të kryera pas rregullimit/servisimit të Automjeteve, në bazë të Kontratës së Prokurimit Nr. 01-370/01-0041283/24, dt. 19.06.2024, Nr. të prokurimit 642-24-5130-2-2-1 dhe Numër të Brendshëm të Prokurimit: 642/24/004-2-2-1, me titull "Mirëmbajtje dhe Servisim të Veturave Zyrtare në KK. Mitrovicë" dhe për të njëjtat të hartoj raport me shkrim duke përshkruar gjendjen faktike, mbarëvajtjen e punëve gjatë rregullimit/servisimit të automjeteve që janë në pronësi të komunës dhe institucioneve vartëse të komunës, të cilin raport së bashku me kontratën do t'i dorëzoj Drejtorit të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme si dhe Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

3. Komisioni punues bazë për punën e tij do të ketë Rregullin Financiare Nr. 01/2013/MF – Shpenzimi i Parave Publike, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.



81.

4. Komisioni i formuar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi ka mandat deri në përfundim të detyrave me këtë Vendim, konkretisht, përfundimit të Kontratës së Prokurimit Nr. 01-370/01-0041283/24, dt.19.06.2024, Nr. të prokurimit 642-24-5130-2-2-1 dhe Numër të Brendshëm të Prokurimit: 642/24/004-2-2-1, me titull "Mirëmbajtje dhe Servisim të Veturave Zyrtare në KK. Mitrovicë ".

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës

13.09.24

Bedri HAMZA

Shtojcë:

1x1 Propozim – Vendimi i DAP-së, Nr. 01-020/04-0045388/24, 08.07.2024

T'i dërgohet:

1x1 Kryetarit te Komunes
1x1 Zyrës Ligjore
1x1 Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme
1x1 Drejtorisë per Buxhet dhe Financa
1x1 Drejtorisë se Prokurimit
1x1 Anëtarëve te Komisionit
1x1 Zyrës për Informim
1x1 Arkivit